VENDIM
Nr. 117, datë 22.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "E.T.H.H." SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET "KOZEL", "HELMES 1" DHE "HELMES 2"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pikës 1 germës "a", nenit 5 pika 1 germa "a" dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "E.T.H.H." sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "E.T.H.H." sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5) mungon. Por, duke qenë se aksesi në rrjet i gjeneruesve të vegjël është i garantuar sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pika 29 e nenit 3 dhe neni 42, konsiderojmë se një kërkesë e tij mund të plotësohet në një kohë tjetër pa cenuar procesin e licencimit të këtij subjekti.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "E.T.H.H." sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et: "Kozel" me fuqi 0,5 MW; "Helmes 1" me fuqi 0,8 MW; dhe "Helmes 2" me fuqi 0,5 MW, për një afat 30-vjeçar".
2. Shoqëria E.T.H.H. sh.p.k. të paraqesë në ERE lejen e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes brenda 30 ditëve nga miratimi i saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani